

Vendim nr. 57 datë 03.04.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim, anëtarë në datën 03.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (Dh) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

- KËRKUES:** **DHIONISIOS ALFRED BELERI**, përfaqësuar nga avokate Klodiana Gjyzari, me prokurë.
- OBJEKTI:** **Shfuqizimi i aktit nr. 1938, datë 08.09.2023, njoftuar në datën 11.09.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
- BAZA LIGJORE:** **Nenet 1, pika 3, 2, pika 2, 3, 4, 5, 6, pika 1, 7, 15, 17, 18, 42, 44, 45, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 3 i Protokollit shtesë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahim, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri (*kërkuesi*) ka qenë kandidat për kryetar të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë, i propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë fitojmë”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023.

2. Dy ditë përpara ditës së zgjedhjeve, në datën 12.05.2023, kërkuesi dhe një person tjetër janë arrestuar në flagrancë si të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 328 dhe 25 të Kodit Penal (*KP*). Me vendimin nr. 205, datë 13.05.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë (*gjykata e rrethit Vlorë*), ndër të tjera, ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuesit dhe ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka deklaruar moskompetencën e saj, duke ia dërguar aktet Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë (*GJKKO e Shkallës së Parë*), si gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore.

3. Në datën 14.05.2023 janë zhvilluar zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe me vendimin nr. 194, datë 16.05.2023, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88 ka shpallur kërkuesin fitues. Në vijim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (*KQZ*), me vendimin nr. 611, datë 25.05.2023 ka vendosur dhënien kërkuesit të mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë, qarku Vlorë.

4. Ndërkohë, për kërkesën e Prokurorisë së Posaçme masa shtrënguese e sigurimit personal e vendosur ndaj kërkuesit nga gjykata jokompetente e rrethit dhe për të cilën është kërkuar vazhdimi i zbatimit, i është nënshtruar shqyrtimit tashmë nga gjykata kompetente sipas përcaktimit të nenit 88 të KPP-së. Me vendimin nr. 46, datë 22.05.2023, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*), me vendimin nr. 19, datë 01.06.2023, ka vendosur të miratojë vendimin nr. 46, datë 22.05.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2023-1313 (224), datë

25.07.2023. Në vijim kërkuesi ka paraqitur 2 kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit, të cilat janë rrëzuar nga gjykatat.

5.Kërkuesi ka paraqitur edhe një kërkesë pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe disa të tjera pranë Institucionit për Ekzekutimin e Vendimeve Penale (IEVP), për marrjen e lejes së veçantë për t'u paraqitur dhe për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak Himarë. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 266, datë 26.06.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se nuk është autoriteti kompetent për dhënien e lejes së kërkuar nga kërkuesi, pasi ajo jepet nga drejtori i institucionit, që në rastin konkret rezultoi të jetë IEVP-ja, me pëlqimin paraprak të prokurorit. Ndërsa, mbi kërkesën e fundit të kërkuesit, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me shkresën nr. 1938 prot., datë 08.09.2023 (*shkresa nr. 1938/2023*), ka vendosur refuzimin e saj, me arsyetimin se një kërkesë e tillë nuk parashikohet nga ligji nr. 81/2020, datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Kjo shkresë (nr. 1938/2023) është kundërshtuar nga kërkuesi në rrugë gjyqësore.

6.GJKKO-ja e Shkallës e Parë, me vendimin nr. 371, datë 18.09.2023, ka vendosur shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (*gjykata e rrethit Durrës*), si gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore. Kjo e fundit, me vendimin nr. 137, datë 10.10.2023, ka parashtruar përpara Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen e kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes së kërkuesit, me objekt kundërshtimin e shkresës nr. 1938/2023.

7.Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1810, datë 07.11.2023, ka vendosur zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe gjykatës së rrethit Durrës, duke përcaktuar si gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes, GJKKO-në e Shkallës së Parë. Pa përfunduar ende gjykimi i çështjes nga kjo e fundit, kërkuesi, në datën 03.01.2024, nëpërmjet përfaqësueses së tij të zgjedhur me prokurë, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), për shfuqizimin e shkresës nr. 1938/2023, si të papajtueshme me Kushtetutën. Kolegji i Gjykatës në datën 01.03.2024 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuessit

8. *Kërkuessi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar, se i është cenuar:

8.1. Parimi i barazisë përpara ligjit, i parashikuar nga nenet 18 të Kushtetutës dhe 14 të KEDNJ-së, pasi ai nuk është trajtuar njësoj si shtetasit e tjerë që kanë qenë në të njëjtat kushte me të. Rasti deputetit A.H. është sjellë në vëmendje të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, i cili edhe pse ka qenë nën e masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, nuk është penguar të marrë mandatin e deputetit. Kjo e drejtë i është njohur atij shtetasi me vendimin nr. 4, datë 23.07.2001 të Gjykatës së Lartë. Edhe në rastin e ish-deputetit tjetër M.F., i cili ka qenë nën masën e sigurimit personal “Arresti në burg”, nga parlamenti i është kërkuar leje Prokurorisë së Përgjithshme që ky shtetas të paraqitet në një seancë parlamentare. Nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nga institucionet e burgjeve është dhënë leja dhe shtetasi M.F. është lejuar që të marrë pjesë në dy seanca parlamentare. Në këtë kuptim, nga parlamenti, që është organi i cili ka miratuar ligjet për të drejtat e të burgosurve dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, është interpretuar se jepet leje për t’u paraqitur në seanca parlamentare edhe kur ligji nuk e parashikon një gjë të tillë. Vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk i ka interpretuar si shteruese rastet e parashikuara nga neni 73 i ligjit nr. 81/2020, për shoqërimin e të burgosurve/paraburgosurve jashtë institucionit të paraburgimit.

8.2. *Parimi i mosdënimit pa ligj dhe e drejta për t’u zgjedhur*, pasi refuzimi i tij për t’u lejuar të kryejë “Betimin”, me arsyetimin se nuk ka ligj, bie në kundërshtim me nenet 3 dhe 4 të Kushtetutës, si dhe 13 të KEDNJ-së. Kërkuessi nuk ndodhet në asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 45, pika 3, i Kushtetutës, për kufizimin e së drejtës së tij për t’u zgjedhur. E drejta e tij nuk i është kufizuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me ligj.

8.3. *Parimi i proporcionalitetit*, i parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës, pasi shkresa nr. 1938/2023, për refuzimin e tij për të kryer procedurën e betimit, përbën kufizim pa ligj të së drejtës për t’u zgjedhur. Ekzistenca e një mase sigurimi personal nuk nënkupton kufizimin e së drejtës për t’u zgjedhur, pasi, së pari, Kushtetuta kërkon që ky kufizim të jetë i shprehur në ligj, pra jo i nënkuptuar, dhe, po ashtu, në vendimin gjyqësor me të cilin i është caktuar masa e sigurimit kërkuessit, nuk rezulton një kufizim i tillë. Kufizimet e së

drejtës për t'u zgjedhur të shtetasve që ndodhen nën masën e sigurimit personal "Arresti në burg" nuk ekzistojnë në asnjë legjislacion dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në shkresën e saj nuk i është referuar ndonjë parashikimi ligjor, i cili parashikon të kufizimin e së drejtës për t'u zgjedhur.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në këtë këndvështrim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi kundërshton një akt të pushtetit publik, nga i cili pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeliemeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuari duhet të

shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, referuar rrethanave të çështjes, rezulton se kërkuesi ndodhet i izoluar për shkak të vendosjes ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” dhe ka kërkuar pranë IEVP-së leje të veçantë për t’u paraqitur dhe për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak Himarë, e cila është refuzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 1938/2023. Kjo e fundit rezulton se është kundërshtuar prej kërkuesit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Pa pritur përfundimin e gjykimit nga ato gjykata, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me të njëjtin objekt, kundërshtimin/shfuqizimin e shkresës nr. 1938/2023. Në lidhje me këtë fakt, kërkuesi ka argumentuar se legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion. Sipas tij, mjetet juridike në dispozicion nuk janë efektive, pasi gjykatat kanë dëshmuar se çdo mjet ankimi i përdorur nga ai do të ishte i destinuar të dështonte, bazuar kjo edhe në faktin se edhe gjykimi për kundërshtimin e këtij akti po zvarritet nga gjykatat. Në përfundim, kërkuesi ka argumentuar se i ka përdorur të gjitha mjetet në dispozicion për vendosur në vend të drejtën e tij për t’u zgjedhur dhe nuk ka mjet tjetër për të shteruar, përveç ankimit kushtetues individual. Në këtë kuptim, kërkuesi ka parashtruar se i ka përdorur të gjitha mjetet në dispozicion për vendosur në vend të drejtën e tij për t’u zgjedhur dhe nuk ka mjet tjetër në dispozicion.

13. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve, çmon se pretendimi i kërkuesit se vetëm nëpërmjet ankimit kushtetues individual të paraqitur në këtë Gjykatë mund të vihet në vend e drejta e tij për t’u zgjedhur nuk është i bazuar, pasi në këtë rast ankimi kushtetues individual nuk është mjeti i vetëm që i garanton legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, për sa kohë ai ka nisur një proces gjyqësor pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm me të njëjtin objekt, kundërshtimin/shfuqizimin e shkresës administrative nr. 1938/2023, që lidhet me kufizimin e së drejtës për t’u zgjedhur. Në këtë kuptim, duke qenë se pretendimet e tij për kundërshtimin/shfuqizimin e aktit objekt kërkese kërkuesi ia ka nënshtuar juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se ato mund t’i nënshtrohen kontrollit kushtetues që ushtron Gjykata pas përfundimit të procesit të nisur në ato gjykata.

14. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi ka ende në dispozicion mjete të tjera juridike, të cilat, nga pikëpamja e efektivitetit, janë në gjendje të korrigjojnë të drejtën e cenuar.

15. Për sa më sipër, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohej Gjykatës dhe se në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.